

Data: 12.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ZGJERIMI I SISTEMIT TE RADIOKOMUNIKIMIT

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 32570000-9 Pajisje komunikimi; 45314000-1 Instalim i pajisjeve të telekomunikacionit; 30214000-2 Workstation; 33195100-4 Monitor; 44212250-6 Antena; 48219500-1 Paketa software pwr switch ose rutera; 44321000-6 Kabllo; 44322000-3 Aksesore per kabllo; 48781000-6 Paketa software per menaxhim sistemi; 48982000-5 Paketa software per menaxhim konfigurimesh.

VLERA E FONDIT LIMIT: 118,535,566 (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, ose 1,248,268.39 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nëntë) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 12.06.2026, me kurs këmbimi 94.96 (nëntëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet

ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e

tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.*

Në rastin konkret Njësisa e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë*

5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës." dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: "3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër."

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: "4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit."

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar, përcaktohet se: "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së

përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme, e cila duhet të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt me Nr.1; Nr.6; Nr.7; Nr.11; Nr.20; Nr.21; Nr.22; Nr.24 dhe Nr.25 të Shtojcës 7 “*Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit*”. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: *telefon, e-mail, website* kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në neni 40/3/ 8 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet

të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Nisur nga lloji i mallrave që kërkohen, të cilat janë të rëndësishme për zgjerimin e sistemit të radiokomunikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si një institucion i një rëndësie të veçantë për sigurinë në institucionet e vuajtjes së dënimit, autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale për mallra sa më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të kontratës. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorit Ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së Operatorit Ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këto mallra është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallrat, me garanci e suport teknik.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/katalogje, broshurë ose skedë teknike të prodhuesit për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Në katalog, broshura ose skeda teknike duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mallit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të*

kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknike;”.

Me anë të këtij kriteri, kërkohet të vlerësohet nëse një operator ekonomik ka kapacitetet e duhura për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar Autoritetin Kontraktor se mallrat e ofruara nga operatorët ekonomikë i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për zgjerimin e sistemit të radiokomunikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si një institucion i një rëndësie të veçantë për sigurinë në institucionet e vuajtjes së dënimit, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ broshuë/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/broshuat/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Kjo kërkesë është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Për menaxhimin e sistemit të cilësive” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- ISO 27001 “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- ISO 20000-1 “Për menaxhimin e shërbimeve të IT” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Ky kriter shërben për

njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar/vendosur në treg/ sipas standardit të sipërpërmendur. Nisur nga natyra e objektit të prokurimit, ku kemi jo vetëm furnizim mallrash por edhe shërbime të lidhura me mallrat, si Montimi i perseritesve në pikat e pershkuara në specifikimet teknike; Konfigurimi i perseriteve, testimi dhe regjistrimi në system; Instalimi i programit të monitorimi dhe menaxhimit të perseritesve; Instalimi i radiove pike me pike; Konfigurimi i radiove Pike me Pike dhe testimi i tyre; Instalimi i softëare të monitorimit dhe menaxhimit nga ku do të monitorohet dhe konfigurhet i gjith rrjeti pike me pike që nga radiot dhe deri tek sëitchet; Lidhja e perseriteve me rrjetin IP të krijuar nga radiot pike me pike; Trajnimi i perdouresve dhe administratoreve të sistemit; Operatori ekonomik fitues duhet të marrë perseriper edhe rikonfigurimin e sistemit egzistues pas ndryshimeve që do të behen, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në menaxhimin e cilësisë, menaxhimin e sigurisë së informacionit, menaxhimit të shërbimeve të IT dhe menaxhimit të shëndetit në punë të punonjësve të tyre.

ISO 9001 “Për menaxhimin e sistemit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme) është standard ndërkombëtar që garanton se operatori ekonomik zbaton një sistem menaxhimi cilësie që përmirëson vazhdimisht proceset. Kërkesa për këtë certifikatë siguron që shërbimet ose produktet e kontratës do të përmbushin standarde të larta cilësie dhe do të kryhen me efikasitet.

ISO 27001 “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit” ose ekuivalent (e vlefshme) është vertifikim që garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik përmbush standartet për sigurinë e informacionit (duke qënë se instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve software dhe hardware do të kryhet në një sistem ekzistues të Autoritetit Kontraktor DPB, i cili përmban informacione që kanë rëndësi të lartë për institucioni, duhet të menaxhohen në mënyrë të sigurt) gjatë zbatimit të kontratës. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përqsasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me focus tek siguria. Për operatorët ekonomikë kjo certifikatë është thelbësore për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit, si dhe për të reduktuar rrezikun e shkeljeve kibernetike, duke marrë shkas të rëndësishme se veçante që ka Autoriteti Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, posaçërisht në sistemin e burgjeve, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

ISO 20000-1 “Për menaxhimin e shërbimeve të IT” ose ekuivalent (e vlefshme) është standard që siguron se operatori ekonomik menaxhon dhe ofron shërbime IT në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ai ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve IT, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për klientët dhe përdoruesit përfundimtarë. Siç është sqaruar edhe më sipër referuar specifikimeve teknike, objekti i prokurimit nuk përfshin vetëm furnizim malli, por edhe shërbime të lidhur me mallrat në funksion të zgjerimit të sistemit të Radiokomunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve.

ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve. Kjo kërkesë është e rëndësishme pasi

instalimet do të kryhen në ambjete me rrezikshmëri referuar specifikimeve teknike. Çertifikimet e kërkuara si më sipër, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave të kërkuara më sipër ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c dhe të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”.

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi. Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave së procedurës së prokurimit. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e objektit të kontratës, i cili përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin, testimin, dokumentimin dhe vënien në funksion të një infrastrukture të avancuar

radiokomunikimi të shpërndarë në disa lokacione gjeografike. Referuar specifikimeve teknike, projekti përfshin instalimin e 28 radio linkeve microwave, 15 switch-eve të menaxhueshëm, përsëritësve DMR, sistemeve të energjisë DC, UPS-ve, antenave, sistemeve të tokëzimit, platformave të monitorimit dhe administrimit, si dhe rikonfigurimin e sistemit ekzistues të radiokomunikimit. Përcaktimi i një numri minimal punonjësish është i domosdoshëm për të garantuar që operatori ekonomik disponon burime të mjaftueshme njerëzore për realizimin e punimeve të instalimit, konfigurimit, integritimit, testimit, trajnimit dhe suportit teknik, duke siguruar përmbushjen e kontratës brenda afateve dhe sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

6. Operatori ekonomik, me qëllim garantimin e relizimit me sukses të kontratës sipas termave të referencës, duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik dhe staf teknik të kualifikuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

a) Staf inxhinierik:

- *Të paktën 5 (pese) punonjës të diplomuar në Inxhinieri Elektronike/Inxhinieri Kompjuterike/Informatikë ose ekuivalente.*

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Diplomën e shkollës së lartë;
- Lisëpagesën për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas formatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

b) Staf teknik të kualifikuar:

- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar me PMP (Project Management Professional) nga PMI ose ekuivalent;*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të kualifikuar për Sistemet Radio Komunikimi Digital, IP Multisite;*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për sisteme PoC (Push-to-Talk over Cellular);*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për pajisjet Radio Link Microwave Point-to-Point;*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për pajisje Switch.*
- *Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për software monitorimi dhe konfigurimi të rrjetit Point-to-Point.*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të kualifikuar për rrjetet network, instalim, programim dhe mirëmbajtje;*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit (Cybersecurity).*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi për pajisje dhe instalime elektrike;*
- *Të paktën 4 (katër) punonjës të certifikuar për punime në lartësi;*
- *Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalent);*

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Çertifikatën përkatëse për specialistët e kërkuar;

- Lisëpagesën për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas formatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

**Shënim:* Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një certifikim/kualifikim. Gjithashtu dhe punonjësit e pikës “a” mund të kenë certifikime/kualifikime sipas pikës “b”.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave të kërkuara më sipër ose nëse kërkoheqen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c dhe të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”.

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi i Stafit inxhinierik:

-Të paktën 5 (pese) punonjës të diplomuar në Inxhinieri Elektronike/Inxhinieri Kompjuterike/Informatikë ose ekuivalente.

Kërkesa për disponimin e të paktën 5 (pese) punonjësve të diplomuar në Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Kompjuterike/Informatikë ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me natyrën komplekse dhe shumëdisiplinore të objektit të prokurimit, i cili përfshin zgjerimin dhe integrimin e një sistemi të avancuar radiokomunikimi të bazuar në teknologjinë DMR IP Multisite, implementimin e radio linkeve microwave Point-to-Point, konfigurimin e rrjeteve IP, instalimin e platformave të

monitorimit dhe administrimit, si dhe integrimin e pajisjeve dhe sistemeve të reja me infrastrukturën ekzistuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Referuar specifikimeve teknike, operatori ekonomik duhet të realizojë analizimin e sistemit ekzistues, hartimin e zgjidhjes teknike, planifikimin e konfigurimeve, instalimin dhe konfigurimin e përsëritësve, radio linkeve, switch-eve, sistemeve të energjisë dhe software-ve të monitorimit, si dhe testimin, dokumentimin dhe vënien në funksion të të gjithë sistemit. Gjithashtu, kontrata parashikon rikonfigurimin e rrjetit ekzistues IP, integrimin e radiove DMR/LTE, implementimin e mekanizmave të monitorimit dhe menaxhimit në distancë, si dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe bllokskemave të sistemit. Përmbushja e këtyre detyrave kërkon staf me formim universitar në fusha që lidhen drejtpërdrejt me telekomunikacionin, elektronikën, rrjetet kompjuterike, sistemet e informacionit dhe teknologjitë e komunikimit. Numri prej 5 (pese) inxhinierësh është proporcional me përmasat dhe kompleksitetin e projektit, si dhe me nevojën për zhvillimin paralel të aktiviteteve të projektimit, konfigurimit, integritit, testimit dhe dokumentimit teknik në disa lokacione dhe faza të ndryshme të implementimit, duke garantuar realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi i Stafit teknik të kualifikuar:

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar me PMP (Project Management Professional) nga PMI ose ekuivalent.

Kërkesa për disponimin e të paktën 1 (një) punonjësi të certifikuar PMP (Project Management Professional) nga PMI ose ekuivalent lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe shtrirjen e objektit të prokurimit, i cili përfshin planifikimin, furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin, testimin, dokumentimin, trajnimin të një infrastrukture të avancuar radiokomunikimi të shpërndarë në disa lokacione gjeografike. Referuar specifikimeve teknike, operatori ekonomik duhet të hartojë projekt-planin, të planifikojë burimet njerëzore dhe materiale, të realizojë dokumentacionin teknik dhe bllokskemat e sistemit, të koordinojë instalimin e përsëritësve DMR, radio linkeve microwave, switch-eve, sistemeve të energjisë, platformave të monitorimit dhe integrimin e tyre me sistemin ekzistues të radiokomunikimit. Gjithashtu projekti parashikon realizimin e punimeve në disa faza përgjatë një periudhe implementimi 12-mujore, duke kërkuar koordinim të vazhdueshëm ndërmjet ekipeve teknike, menaxhim të afateve, kontroll të cilësisë, menaxhim të risqeve dhe raportim periodik ndaj Autoritetit Kontraktor. Certifikimi PMP garanton që personi përgjegjës zotëron njohuritë, metodologjitë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për menaxhimin profesional të projekteve komplekse, duke siguruar organizimin efektiv të aktiviteteve, përdorimin optimal të burimeve, respektimin e afateve të kontratës dhe realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 2 (dy) punonjës të kualifikuar për Sistemet Radio Komunikimi Digital, IP Multisite.

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve të kualifikuar për Sistemet Radio Komunikimi Digital, IP Multisite lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe infrastrukturën ekzistuese të radiokomunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila është ndërtuar mbi teknologjinë DMR IP Multisite dhe përbëhet nga disa site të ndërlidhura nëpërmjet rrjetit IP. Referuar specifikimeve teknike, projekti parashikon zgjerimin e sistemit aktual me përsëritës të rinj në pikat Çardhakë dhe Tyrbe, integrimin e tyre me sistemin ekzistues, lidhjen e tyre në rrjetin IP të radiokomunikimit, si dhe integrimin e plotë me platformën ekzistuese Smart Dispatch Plus. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohen specialistë që zotërojnë njohuri dhe eksperiencë në konfigurimin e sistemeve DMR Tier III, administrimin e arkitekturave IP Multisite, menaxhimin e roaming-ut ndërmjet site-ve, konfigurimin e grupeve të komunikimit, GPS tracking, monitorimin dhe administrimin në distancë të pajisjeve, si dhe integrimin e sistemeve ekzistuese me komponentë të rinj.

Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të kryejë rikonfigurimin e sistemit ekzistues pas ndryshimeve të adresimit IP dhe implementimit të rrjetit të ri të komunikimit, proces i cili kërkon njohuri të specializuara mbi funksionimin e sistemeve të radiokomunikimit dixhital. Numri prej 2 (dy) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit dhe nevojën për realizimin paralel të aktiviteteve të instalimit, konfigurimit, integrimin dhe testimin në disa lokacione, duke garantuar funksionimin pa ndërprerje të sistemit ekzistues dhe realizimin me sukses të zgjerimit të infrastrukturës sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për sisteme PoC (Push-to-Talk over Cellular).

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve të certifikuar për sisteme PoC (Push-to-Talk over Cellular) lidhet drejtpërdrejt me specifikimet teknike të projektit, të cilat parashikojnë furnizimin me radio dore dual mode DMR/LTE, licencimin e tyre dhe integrimin e plotë me sistemin ekzistues të radiokomunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Referuar specifikimeve teknike, radiot duhet të operojnë si në rrjetin DMR ashtu edhe në rrjetet LTE, duke mundur kalimin automatik nga teknologjia DMR në LTE dhe anasjelltas në varësi të mbulimit dhe kushteve të komunikimit, pa ndërprerje shërbimit dhe funksionalitetet operative. Gjithashtu, sistemi ekzistues përfshin gateway për integrimin e rrjeteve DMR dhe LTE, si dhe funksione të avancuara si komunikimi zanor, video thirrjet, transmetimi i fotove dhe videove, mesazhet zanore, GPS tracking dhe menaxhimi në distancë i terminaleve. Implementimi dhe konfigurimi i këtyre funksionaliteteve kërkon specialistë me njohuri të avancuara në teknologjitë PoC, rrjetet celulare LTE, konfigurimin e profileve të komunikimit, menaxhimin e licencave, integrimin me sistemet dispatcher dhe administrimin e platformave të komunikimit kritik. Numri prej 2 (dy) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit dhe nevojën për realizimin paralel të aktiviteteve të konfigurimit, integrimin, testimin dhe optimizimit të pajisjeve në rrjetet DMR dhe LTE, duke garantuar funksionimin korrekt të sistemit dhe përbushjen e të gjitha kërkesave teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

-Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për pajisjet Radio Link Microwave Point-to-Point.

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve të certifikuar për pajisjet Radio Link Microwave Point-to-Point lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, i cili parashikon furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe vënien në funksion të 28 radio linkeve microwave që do të ndërtojnë rrjetin IP të komunikimit ndërmjet site-ve të sistemit të radiokomunikimit dhe do të mundësojnë ndërlidhjen e përsëritësve ekzistues dhe të rinj me qendrën e monitorimit në DPB. Referuar specifikimeve teknike, këto pajisje mbështesin teknologji të avancuara si XPIC, MIMO 2x2 dhe 4x4, ACM (Adaptive Coding and Modulation), Carrier Ethernet 2.0, QoS, VLAN, REST API, SNMP, NETCONF/YANG, si dhe protokolle të sinkronizimit dhe sigurisë të përdorura në rrjete kritike komunikimi. Implementimi i një infrastrukture të tillë kërkon specialistë me njohuri të specializuara në projektimin e lidhjeve microwave, llogaritjen e parametrave të transmetimit, orientimin dhe kalibrimin e antenave, konfigurimin e pajisjeve, optimizimin e performancës së lidhjeve, testimin e kapaciteteve të transmetimit dhe integrimin e tyre me rrjetin ekzistues IP. Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të realizojë lidhjen e të gjithë përsëritësve, gateway-ve LTE, radiove mobile dhe pajisjeve të tjera në rrjetin e ri të komunikimit, çka e bën infrastrukturën microwave komponentin kryesor të funksionimit të sistemit. Numri prej 2 (dy) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit, shpërndarjen gjeografike të site-ve dhe nevojën për realizimin paralel të aktiviteteve të instalimit, konfigurimit dhe testimin, duke garantuar ndërtimin e një rrjeti të qëndrueshëm, të sigurt dhe me performancë të lartë sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për pajisje Switch.

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve të certifikuar për pajisje Switch lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, i cili parashikon furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe integrimin e 15 switch-eve të menaxhueshëm PoE që do të përbëjnë bazën e rrjetit IP të sistemit të radiokomunikimit. Referuar specifikimeve teknike, këto pajisje duhet të mbështesin funksione të avancuara si VLAN, Inter-VLAN Routing, QoS, SNMP, Radius, TACACS+, DHCP Snooping, OSPF, RIP, ACL, Link Aggregation, Spanning Tree, IGMP, Port Security dhe protokolle të tjera të nevojshme për administrimin dhe sigurinë e rrjetit. Switch-et do të përdoren për ndërlidhjen e radio linkeve microwave, përsëritësve DMR, platformave të monitorimit, sistemeve të energjisë dhe pajisjeve të tjera aktive të rrjetit, duke luajtur një rol kritik në garantimin e komunikimit të pandërprerë ndërmjet të gjitha site-ve të sistemit. Për këtë arsye kërkohen specialistë të certifikuar që zotërojnë njohuri të provuara në konfigurimin, administrimin, monitorimin dhe optimizimin e infrastrukturave të avancuara të switching-ut, si dhe në implementimin e politikave të sigurisë dhe segmentimit të trafikut. Numri prej 2 (dy) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit dhe nevojën për realizimin paralel të aktiviteteve të instalimit, konfigurimit, integritit dhe testimit të pajisjeve në disa lokacione, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe me performancë të lartë të rrjetit IP sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për software monitorimi dhe konfigurimi të rrjetit Point-to-Point.

Kërkesa për disponimin e të paktën 1 (një) punonjësi të certifikuar për software monitorimi dhe konfigurimi të rrjetit Point-to-Point lidhet drejtpërdrejt me kërkesat e specifikimeve teknike, të cilat parashikojnë implementimin e një platforme të centralizuar për monitorimin, administrimin dhe konfigurimin e të gjithë infrastrukturës së komunikimit, duke përfshirë radio linket microwave, switch-et, pajisjet aktive të rrjetit dhe komponentët e tjerë të sistemit. Referuar specifikimeve teknike, platforma duhet të ofrojë funksionalitete të avancuara si monitorim në kohë reale, Zero Touch Provisioning, Auto Provisioning, RESTful API, menaxhim të roleve dhe përdoruesve, backup të konfigurimeve, disaster recovery, upgrade firmware, menaxhim të alarmeve, raportim statistikash, load balancing, high availability dhe integrim me sisteme autentifikimi si Radius, TACACS+, LDAP dhe Active Directory. Implementimi dhe administrimi i një platforme me këto karakteristika kërkon njohuri të specializuara në instalimin, konfigurimin, integrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të rrjeteve, si dhe në monitorimin e performancës dhe sigurisë së infrastrukturës. Prania e një specialisti të certifikuar garanton konfigurimin korrekt të platformës, integrimin e saj me të gjitha pajisjet e rrjetit, menaxhimin e sigurt të konfigurimeve dhe monitorimin e vazhdueshëm të sistemit, duke siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe administrimin efikas të të gjithë rrjetit të radiokomunikimit sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 2 (dy) punonjës të kualifikuar për rrjetet network, instalim, programim dhe mirëmbajtje.

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve të kualifikuar për rrjetet network, instalim, programim dhe mirëmbajtje lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili bazohet në ndërtimin dhe administrimin e një infrastrukture të avancuar IP që do të ndërlidhë përsëritësit DMR, radio linket microwave, switch-et, gateway-t për integrimin e rrjeteve LTE, workstation-et, sistemet e monitorimit dhe komponentët e tjerë të rrjetit të radiokomunikimit. Referuar specifikimeve teknike, operatori ekonomik duhet jo vetëm të instalojë dhe konfigurujë pajisjet e reja, por edhe të realizojë rikonfigurimin e sistemit ekzistues pas ndryshimit të adresimit IP, duke siguruar funksionimin korrekt të të gjithë komponentëve të integruar në rrjet. Këto procese kërkojnë njohuri të specializuara në routing, switching, VLAN, adresim IP, menaxhim të trafikut,

konfigurim të shërbimeve të rrjetit, monitorim të performancës dhe administrim të infrastrukturave komplekse të komunikimit. Gjithashtu, specialistët do të angazhohen në integrimin e pajisjeve me platformat e monitorimit, testimin e lidhjeve ndërmjet site-ve, optimizimin e performancës së rrjetit dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit gjatë fazës së implementimit dhe pas vendosjes në operim. Numri prej 2 (dy) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit dhe nevojën për realizimin paralel të aktiviteteve të instalimit, konfigurimit, integrimin, testimin dhe mirëmbajtjes së rrjetit në disa lokacione të ndryshme, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe me performancë të lartë të infrastrukturës së radiokomunikimit sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit (Cybersecurity).

Kërkesa për disponimin e të paktën 1 (një) punonjësi të certifikuar për sigurinë e rrjetit (Cybersecurity) lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe rëndësinë e sistemit që do të implementohet, i cili përdoret për komunikime operative dhe shkëmbim informacioni ndërmjet strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Referuar specifikimeve teknike, infrastruktura e projektit përfshin rrjete IP, radio linke microwave, sisteme radiokomunikimi DMR dhe LTE, platforma monitorimi dhe administrimi, si dhe mekanizma të avancuar autentifikimi, autorizimi dhe enkriptimi. Pajisjet dhe sistemet e parashikuara në projekt mbështesin protokolle dhe teknologji sigurie si SNMPv3, HTTPS, SSH, Radius, TACACS+, LDAP, Active Directory, AES-256 Encryption dhe mekanizma të tjerë të mbrojtjes së komunikimeve dhe aksesit në rrjet. Gjithashtu, platforma e monitorimit do të administrojë në mënyrë të centralizuar të gjithë infrastrukturën e komunikimit dhe do të ruajë të dhëna operative, konfigurime dhe log-e të sistemit, të cilat kërkojnë mbrojtje të vazhdueshme nga akseset e paautorizuara, sulmet kibernetike dhe incidentet e sigurisë. Për këtë arsye, kërkohet një specialist i certifikuar në fushën e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, i cili të garantojë konfigurimin e sigurt të pajisjeve, implementimin e politikave të sigurisë, kontrollin e aksesit, mbrojtjen e komunikimeve dhe verifikimin e përputhshmërisë së zgjidhjes së implementuar me kërkesat e sigurisë të përcaktuara në specifikimet teknike. Kjo kërkesë është proporcionale me rëndësinë e sistemit dhe synon të sigurojë integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e infrastrukturës së radiokomunikimit gjatë implementimit dhe operimit të saj.

-Të paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi për pajisje dhe instalime elektrike.

Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve të pajisur me dëshmi kualifikimi për pajisje dhe instalime elektrike lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin instalimin dhe vënien në funksion të përsëritësve DMR, radio linkeve microwave, switch-eve PoE, UPS-ve, stacioneve të energjisë DC, sistemeve të tokëzimit, shkarkuesve të mbitensionit dhe pajisjeve të tjera aktive të rrjetit. Referuar specifikimeve teknike, një pjesë e konsiderueshme e pajisjeve do të furnizohet me energji elektrike AC dhe DC dhe kërkon realizimin e lidhjeve elektrike, sistemeve të mbrojtjes, tokëzimit dhe furnizimit rezervë me energji, sipas standardeve teknike dhe rregullave të sigurisë elektrike. Gjithashtu, projekti përfshin instalimin e 10 stacioneve të energjisë DC, 5 UPS-ve, sistemeve të mbrojtjes nga mbitensionet dhe pajisjeve të tjera që kërkojnë njohuri të specializuara në instalime elektrike për të garantuar funksionim të sigurt dhe të pandërprerë të infrastrukturës së radiokomunikimit. Numri prej 2 (dy) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit dhe nevojën për realizimin paralel të punimeve në disa lokacione, duke garantuar zbatimin korrekt të instalimeve, minimizimin e rreziqeve teknike dhe elektrike, si dhe përmbushjen e kërkesave të sigurisë, cilësisë dhe besueshmërisë të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 4 (katër) punonjës të certifikuar për punime në lartësi.

Kërkesa për disponimin e të paktën 4 (katër) punonjësve të certifikuar për punime në lartësi lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, i cili përfshin instalimin, montimin, konfigurimin dhe testimin e antenave VHF, antenave microwave, radio linkeve Point-to-Point, sistemeve të tokëzimit, kablllove të komunikimit, shkarkuesve të mbitensionit dhe pajisjeve të tjera të radiokomunikimit në kulla dhe struktura të ngritura të vendosura në disa site të ndryshme gjeografike. Referuar specifikimeve teknike, operatori ekonomik do të realizojë instalimin e 28 radio linkeve microwave, 28 kompleteve të aksesorëve të montimit, antenave microwave dhe pajisjeve të tjera të lidhura me rrjetin e radiokomunikimit, ku një pjesë e konsiderueshme e punimeve do të kryhet në lartësi dhe në kushte operative me rrezik të shtuar si kulla me të larta se 15 m. Përveç montimit fizik të pajisjeve, këto punime përfshijnë edhe orientimin dhe kalibrimin e antenave, fiksimin e kablllove, realizimin e sistemeve të tokëzimit dhe kryerjen e testeve teknike, procese të cilat kërkojnë personel të trajnuar dhe të certifikuar për të garantuar sigurinë gjatë punës dhe cilësinë e instalimit. Numri prej 4 (katër) specialistësh është proporcional me përmasat e projektit, shpërndarjen e pikave të instalimit dhe nevojën për kryerjen e punimeve në mënyrë simultane, duke garantuar respektimin e standardeve të sigurisë në punë, minimizimin e rrezikut për personelin dhe realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

-Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalent).

Kërkesa për disponimin e të paktën 1 (një) punonjësi të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalent) lidhet drejtpërdrejt me natyrën e projektit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin dhe instalimin e pajisjeve hardware, por edhe implementimin e platformave software për monitorimin, administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së radiokomunikimit. Referuar specifikimeve teknike, operatori ekonomik duhet të instalojë dhe konfigurojë sistemet e monitorimit dhe menaxhimit të përsëritësve, radio linkeve dhe switch-eve, të administrojë përdoruesit dhe nivelet e aksesit, të realizojë konfigurime, backup-e, përditësimet software, monitorim të vazhdueshëm të performancës dhe të ofrojë suport teknik gjatë periudhës së garancisë. Gjithashtu, specifikimet kërkojnë funksionalitete si menaxhimi i alarmeve, gjenerimi i raporteve, disaster recovery, high availability, menaxhimi i konfigurimeve dhe ruajtja afatgjatë e të dhënave, procese të cilat lidhen drejtpërdrejt me praktikën e menaxhimit të shërbimeve IT. Një specialist i certifikuar ITIL ose ekuivalent garanton që këto shërbime të organizohen dhe administrohen sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, duke siguruar menaxhimin efektiv të incidenteve, ndryshimeve, problemeve, konfigurimeve dhe niveleve të shërbimit, si dhe duke garantuar vazhdimësinë operacionale, gjurmueshmërinë e veprimeve dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara gjatë implementimit, periudhës së garancisë dhe suportit teknik. Kjo kërkesë është proporcionale me rëndësinë e sistemit dhe synon të sigurojë administrimin e qëndrueshëm dhe efikas të infrastrukturës së implementuar sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 2 (dy) mjete transporti të përshtatshëm për transportin e mallrave objekt prokurimi. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qera/huapërdorje, vërtetuar me dokumentet:

- Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje/huapërdorje (e vlefshme);
- Leje qarkullimi;
- Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm);

- Sigurimin e detyrueshëm të mjetit (e vlefshëm).

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumentave të kërkuara më sipër ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi dhe pozicionin gjeografik të territorit ku do të realizohen furnizimet/instalimet dhe shërbimetreferuar specifikimeve teknike.

8.Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimi, sipas kushteve të përcaktuar në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallrat e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që mallrat i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi, instalimi apo konfigurimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit

për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike për objektin e prokurimit janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si më poshtë;

Referuar nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se:

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet

e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.


Grupi i punës hartoi dhe argumentoi specifikimet teknike për objektin e prokurimit si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti: “Zgjerim i sistemi te Radiokomunikmit”

1. Situata aktuale dhe objektivat e Kontrates

a. Situata aktuale.



b. Nje bllokskeme e sistemit egzistues te radiokomunikimit jepet si ne figuren e me poshteme. Sistemi eshte ndertuar ne teknologjine IP multisite. Ne total sistemi ka 7 site te cilat jane Mide, Tarabosh, Dajt, Ardenice, Zverniec, Petresh dhe Cervenake. Ne cdo site ndodhet nje perserites i modelit Hytera HR1065 i cili eshte lidhur ne nje rrjet IP. Me vendosjen e perseritesve ne keto pika dhe lidhja e tyre ne nje rrjet IP ka bere te mundur qe te gjitha IEVP

te lidhen me Sallen qendrore ne DPB. Duke qene te lidhur ne nje sistem IP multisite eshte e mundur qe te perdoren te gjitha vecorite e ketij sistemi si:

- Roaming. Nje radio kalon nga nje site ne nje tjeter pa humbur sinjalin.
- Dergimi i vendnodhjes dhe shpejtesise se levizjes me ate te sinjalit GPS.
- Regjistrimi dhe playback i te gjitha komunikimeve.
- Regjistrimi dhe rikthimi i levizjeve me ane te GPS dhe hartave te Google.
- Thirje individualisht te radiove direkt nga harta.
- Aktivizimi dhe caktivizimi i radiove ne remote.
- Marrja e alarmeve per geofencing, tejkalim shpejtesie apo lone worker, man down etj.
- Monitorimi ne remote i radiove.
- Konfigurimi ne remote i radiove.
- Dergimi i mesazhe tekst, mesazheve te shkurtra te prekonfigurara apo mesazhe statusi.
- Komunikim audio ne kanale dixhitale duke ofruar cilesi te larte dhe qartesi ne te folur.
- Ndarja e radiove me zona dhe me grupe.
- Komunikime individuale apo ne grup.
- Perdorimi i dy sloteve per voice dhe data.
- Marrja dhe ruajtja e logeve te komunikimit, statusit, loge e GPS etj.

Ne investimin e bere ne vitin 2025 DPB ka marre nje sasi radiosh dual mode te cilat punojne ne DMR dhe LTE. Keto terminale me ane te nje gateway jane integruar me sistemin egzistues dhe eshte e mundur te komunikohet nga rrjeti LTE ne ate DMR. Kjo ka permiresuar ndjeshem zonen e mbulimit pasi ne zonat ku nuk arrihet te mbulohet me rrjet DMR radiot kalojne ne LTE. Gjithashtu jane shtuar edhe vecori te tjera si video call ne grup apo individualisht apo dergimi i mesazheve zanore, dergimi i videove dhe fotove me mesazhe etj.

c. *Objektivat*

Objektivi i kesaj kontrate eshte zgjerimi i sistemi aktual me perserites te tjere te cilet do te jene ne perputhje te plote me sistemin aktual dhe te gjitha vecorite e sistemit aktual. Perseritesit qe do te shtohen do te instalohen ne pikat: Çardhake prane Korces dhe Tyrbe prane Lezhes dhe do te ndihmoje ne zgjerimin e mbulimit per sistemin e Radiokomunikimit ne teknologjine DMR. Perseritesit duhet te jen kompatibel dhe te integrohen ne sistemin aktual dhe ne programin Smart Dispatch+ qe ndodhet ne DPB.

Nje nga objektivat e kesaj kontrate eshte edhe realizimi i nderlidhjes midis repetitorve nepermjet Radiolinkeve Mikrowave ndertimi pike me pike (Point-to-Point) ne funksion te sistemit te Radiokomunikimit. Ky rrjet do te lidhe te gjitha perseritesit ne nje rrjet IP dhe rrjedhimisht edhe me sallen ne DPB nga ku do te behet edhe monitorimi dhe konfigurimi i perseritesve.

Operatori Ekonomik Fitues duhet te lidhe ne kete rrjet perseritesit e sistemi egzistues, perseritesit qe do te shtohen, gateway qe perdoret per integrimin e radiove LTE si dhe ne disa IEVP dhe radiot mobile.

Operatori Ekonomik Fitues duhet te beje te gjitha konfigurimet (ku perfshihet edhe nderrimi i IP) e sistemi egzistues pasi te ndryshoje rrjeti IP ku do te lidhen, perfshi ketu perseritesit, radio mobile, gateway dhe Radiot LTE.

Gjithashtu ky rrjet do te perdoret edhe per qellime te tjera nga DPB si rrjet per shkembim data apo sherbime te tjera nga IEVP te ndryshme.

2. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Rezultate qe priten te arrihen nga kontraktori jane:

- Furnizimi, instalimi, konfigurimi i perseritesve qe do te shtohen ne sistem.

- Instalimi dhe konfigurimi i programit per monitorimin dhe menaxhimin e te gjithë perseritesve.
- Furnizimi dhe instalimi i radiove pike me pike.
- Konfigurimi i radiove pike me pike dhe instalimi software se monitorimit dhe menaxhimit ne DPB.
- Trajnimi i perdoruesve dhe administratoreve te sistemit.

3. Siguria e Sistemit

- Sistemi do te jete i mbyllur dhe do te perdoret vetem per qellime te brendshme.
- Administrimi i çdo përdoruesi duhet të realizohet nëpërmjet aplikacionit, nëpërmjet të cilit do të mundësohet krijimi i përdoruesve të rinj dhe menaxhimi i atyre ekzistues.

4. Detyrat specifike

- Furnizimi i paisjeve
- Montimi i perseritesve ne pikat e pershkruara me siper.
- Konfigurimi i perseriteve, testimi dhe regjistrimi ne sistem.
- Instalimi i programit te monitorimi dhe menaxhimit te perseritesve
- Instalimi i radiove pike me pike.
- Konfigurimi i radiove Pike me Pike dhe testimi i tyre.
- Instalimi i software te monitorimit dhe menaxhimit nga ku do te monitorhet dhe konfigurhet i gjith rrjeti pike me pike qe nga radiot dhe deri tek switchet.
- Lidhja e perseriteve me rrjetin IP te krijuar nga radiot pike me pike
- Trajnimi i perdouresve dhe administratoreve te sistemit.

Opertori ekonomik fitues duhet te marre perseriper edhe rikonfigurimin e sistemit egzistues pas ndryshimeve qe do te behen.

4.1 Hartimi i projekt-planit dhe ndjekjes së tij deri në realizimin e plotë

- Planifikimi i burimeve njerëzore dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projektit.
- Realizimi i një plani të detajuar mbi zhvillimin e projektit dhe implementimit te zgjidhjes.
- Realizimi i dokumentacionit teknik ku të detajohet dhe përcaktohet me saktësi te gjitha ndryshimet dhe konfigurimet qe do te behen ne sistem si dhe bllokskemat e nevojshme.

4.2 Instalimi dhe konfigurimi i perseritesve

- Instalimi i perseritesve ne pikat e percaktuara nga DPB.
- Vendosja e frekuenca dhe konfigurimi i tyre
- Instalimi i programit per monitorimin dhe menaxhimin e perseritesve.

4.3 Instalimi dhe konfigurimi i radiove pike me pike

- Instalimi i te gjitha radiove.
- Konfigurimi i tyre.
- Instalimi i platformes per monitorimin dhe menaxhimin e te gjitha paisjeve te rrjetit pike me pike.

4.3 Testimi i sistemit

- Testimi i komunikimit midis të gjitha pikave ku kryhen operacione teknike.
- Testimi i zonave të mbulimit dhe pikave pa mbulim.
- Testimi i komunikimit midis Qendrës dhe çdo njësie ku është vendosur radio.

4.4 Trajnimi dhe marrja në dorëzim

- Trajnimi i përdoruesve të radios dhe përdoruesve të programit të dispatcherit.
- Marrja në dorëzim.

5. Raportimi

Operatori ekonomik i kontraktuar do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe, në origjinal dhe të paktën një (1) kopje:

- Raporti fillestar prej minimumi 5 faqesh duhet të prodhohet pas dy javësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Operatori ekonomik i kontraktuar duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar.
- Raporti final me detajet dhe specifikat e implementimit të projektit prej minimumi 10 faqesh. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është në momentin e marrjes në dorëzim të projektit. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Përmbushja e secilës nga fazat e projektit dokumentohet me procesverbal të përpiluar nga ofruesi i shërbimit dhe të firmosur nga punonjësit përgjegjës të të dy palëve.

6. Garancia, Suporti dhe Licensat

6.1 Garancia

Kushtet e garancisë për pajisjet hardware dhe komponentët software do të jenë në përputhje me kushtet e prodhuesit, sipas specifikimeve teknike. Afati i garancisë për të gjitha pajisjet: 2 vjet.

6.2 Shërbimi i Suportit

Në mbështetje të kërkesës për mirëmbajtje të sistemit të implementuar, pajisjet *hardware* dhe komponentët *software* do të ofrohen me shërbime garancie dhe suporti nga prodhuesi, sipas termave të garancisë.

Shërbimi i suportit do të përfshijë riparimin ose zëvendësimin, konfigurimin dhe kalibrimin e pajisjeve *hardware* dhe konfigurimin, ri-konfigurimin dhe përditësimet me versionet e fundit falas për komponentët *software*, sipas termave të garancisë.

Periodha e mbulimit me shërbim suporti do të jetë jo më pak se një vit kalendarik nga data e firmosjes së aktit të kolaudimit.

6.3 Licensat

Përdoruesi dhe përfituesi fundor (end-user) i çdo licence, i dokumentuar dhe me të drejta shtyrje ose ripërtëritje të periudhës së vlefshmërisë, për të gjitha licensat e nevojshme do të jetë DPB.

Vlefshmëria e licencave do të dokumentohet si më poshtë:

- me deklarate / dokument zyrtar nga prodhuesi; ose

- ne format elektronik: licence key ose certifikatë; ose
- qasje ne portalin zyrtar te prodhuesit.

7. Lista e Materialeve

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Perserites VHF, 50W paisur me aksesoret e montimit	Cope	2
2	Duplexer VHF	Cope	2
3	Antene VHF	Cope	2
4	Kabell koaksial 7/8	ml	200
5	Konektor per kabell 7/8	cope	4
6	Software per monitorimi dhe konfigurim te perseritesve OTAP bashke me licensat perkatese per 10 perserites	Cope	1
7	Radio Link Microwave, Paisur me aksesor dhe licensa	Cope	28
8	Aksesor per fiksimin e kabujve	kit	28
9	Aksesor per fiksimin e radiove	kit	28
10	Shkarkues mbitemension (56V), 1000 BaseT	Cope	56
11	SwitchPoE, 8x 1gbps and 4 SFP+,	Cope	15
12	Antene 0.9m	Cope	16
13	Antene 1.2m	Cope	12
14	Kabell tokezimi bashke me fiksuese kit	kit	28
15	Kit per tokezimin e kabujve ftp	kit	56
16	Konektore RJ45 per kabell CAT6A	Cope	56
17	Kabell CAT6A Outdoor	ml	1000
18	Workstation	Cope	2
19	Monitor 24"	Cope	2
20	Software monitorimit dhe konfigurimit te rrjetit pike me pike antenat dhe switchet bashke me licensat perkatese	Cope	1
21	STACION ENERGJIE DC	COPE	10
22	UPS 1000VA	Cope	5
23	Rack per instalimin e paisjeve	Cope	15
24	Radio dore DMR LTE	cope	40
25	Licensa sistemi per Radio dore DMR LTE	cope	40
26	Instalim, konfigurim I sistemit	set	1

8. Afati kohor i implementimit te projektit

duke patur parasysh dhe kompleksitetin ne fazen e planifikimit dhe realizimi parashikohet te kryhet brenda nje periudhe 12 (dymbedhjet) mujore si me poshte:

Nr.	Emertimi i fazes/ Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10	M11	M12
1	Pergatitja dhe planifikimi	x											
2	Furnizimi i pajisjeve		x	x	x	x							
3	Instalimi				x	x	x	x	x	x			
4	Konfigurimi dhe testimi									x	x	x	
5	Trajnimi												x
6	Marrja ne dorezim												x

9. Specifikimet Teknike

9.1 Perserites (Repeater) 50W DMR me antene, bateri, aksesore dhe licensa

Operatori Ekonomik duhet te ofroje pajisjen Perseritese (Repeater) me karakteristikat e meposhtme:

- Te suportojte protokollet dixhitale DMR Tier III trunking.
- Te jete ne perputhje me protokollet ETSI-TS102 361 – 1,-2,-3.
- Koha e funksionimit: 100 % pa nderprerje (100% duty cycle).
- Te lejoje lidhjen nepermjet protokollit IP.
- Te lejoje kontroll dhe monitorim ne distance.
- Frekuenca e punes te perfshije brezin VHF (136-174 MHz).
- Ndjeshmeri ne marrje: jo me pak se 0.2 μ V (ne dixhital).
- Fuqia transmetimi: jo me pak se 50 Watt.
- Kapaciteti i kanaleve: jo me pak se 64.
- Hapesira ndermjet kanaleve: 12.5/20/25 kHz.
- Stabiliteti i frekuences se marresit: $\leq \pm 0.5$ ppm.
- Shtremberimet e zhurmave audio: $\leq 3\%$.
- Te punoje ne ambiente me ndryshim temperature nga -30 ne +60 Grade C.
- Tensioni i punes te perfshije: AC: 100 – 240V dhe te kete mundesi per ushqim DC backup ne rast se AC mungon.
- I kompletuar me aksesoret perkates:
- Antene me amplifikim min. 5 dBi.
- Kabull RF.
- Ushqyes 220VAC, 50Hz.
- Bateri per backup.
- Aksesore montimi te pajisjes ne kabinet.
- Aksesore te antenes.
- Licensa per regjistrim ne sistem.
- Te kete nje Gateëay te integruar per tu lidhur me sistemet VoIP nepermjet protokollit SIP.
- Perseritesi te jete i paisur me 2 porta rrjeti RJ45.
- Te kete mundesi te menaxhohet me nderfaqe Web.
- Te kete mundesi monitorimi nepermjet protokolleve SNMP V3 dhe te perdorur komunikim te enkriptuar.
- Perseritesi (Repeater) te ket mundesi qe te krijojte nje link wireless me nje site tjetër nese nuk ka link IP.
- Perseritesi te kete mundesi te punoje edhe ne analog dhe te kete mundesi te detektojte komunikimin dhe ne menyre automatike te kalojme midis komunikimit analog dhe digital.
- Te suportojte API per integrim me pale te treta.
- Perseritesi duhet te jete kompatibel dhe te integrohet me sistemin egzistues te radio komunikimit.

9.2 Radio dore DMR dhe LTE

Radio te kete mundesi komunikimi duke perdorur teknologjite e meposhtme:

- DMR – me brez frekuence 136 - 174 Mhz
- LTE ne bandat: B1, B2, B3, B4, B5, B7, B8, B20, B26, B28, B38, B39, B40, B41.
- CDMA
- WCDMA ne bandat: B1, B2, B4, B5, B8.

- GSM ne bandat: 850, 900, 1800, 1900 MHz.
- WLAN ne perputhje me: 802.11 a/b/g/n/ac
- Lokalizim: GPS/BDS/GLONASS/Galileo/QZSS dhe A-GPS.
- Bluetooth: BDR/EDR/BLE

Hapsira ndermjet kanaleve: 12.5KHz/ 20KHz/ 25KHz.

Fuqia e transmetimit jo me e vogel se 4W (DMR)

Ndjeshmeria e marresit (digital): $\leq 0.16\mu V/-123$ dBm

Stabiliteti i frekuences: $\leq \pm 0.5$ ppm.

Radio te jete e paisur me procesor me frekuence pune jo me te vogel se 1.8GHz.

Dalje Audio – minimumi 2W

Te jete e paisur me Android 10 ose me te ri.

Te kete te pakte 3 GB RAM dhe 32 GB storage.

Te pranoje karta Micro SD.

Te kete nje ekran me prekje te pakten 3.6”.

Radio te jete e paisur me nje ekran te dyte te vogel bardh e zi i cili shfaqe parametrat kryesor dhe ndihmon ne kursim e baterise.

Ekрани te jete rezistent ndja gervishtjeve, goditjeve, vajit apo papastertive te tjera.

Te jete i paisur me butona fizikie si: PTT, celes rrotullues per volumin, dhe butona me funksione te konfigurueshme.

Te jete i pasur me filter per shuarjen e zhurmave.

Te jete i pasur me 2 kamera ku kamera e pasme te kete rezolucion 13 MP ose me te mire.

Te mund te regjistroje video ne Full HD me 30 fps ose me mire.

Te kete slote per 2 karta SIM.

Te jete i paisur me sensoret: Proximity, sensor drite, accelerometer, gyroscope, magnetometer.

Te jete i paisur me bateri 2400 mAh ose me te madhe.

Te suportojte stanartet e meposhtme per multimedia:

- Video: 3gp, mp4, mov, webm, asf, wmv, rmvb, rm, mpg, mpeg, ts, avi, mkv
- Foto: jpg, gif, png, bmp.
- Audio: mp3, wav, 3gp, mp4, aac, ts, flac, ota, imy, ogg, ac3, mka, wma.

Radio te mund te kaloje nga DMR ne LTE ne menyre automatike ne varesi te komunikimit.

Radio te kete enkriptim software dhe hardware per komunikim te sigurt.

Radio te kete mundesi te menaxhohet dhe monitorohet ne remote.

Radio te jete e mbrojtur ne perputhje me standartin IP68 per mbrojtjen nga pluhurat dhe uji.

Radio te jete ne perputhje me stasndartin MIL-STD-810G, standart ushtarak qe siguron se radiot mund ti rezistojne kushteve te veshtira gjate gjithë jetegjatesise se tyre te sherbimit.

Radio te jete ne perputhje me standartin IEC 61000-4-2 (Level 4) per te siguruar imunitet ndaj shkarkimeve elektrostatike (ESD).

Te punoj ne temperaturat -20°C deri ne $+60^{\circ}\text{C}$.

- E kompletuar me aksesoret:
 - o Karikues
 - o Baze karikimi per tavoline
 - o Bateri jo me te vogel se 2400 mAh
 - o Antene
 - o Kapese rripi

9.3 License per radio dore DMR dhe LTE

Radiot e ofertuara nga OE duhet te jene kompatibel me sistemin egzistues dhe kompatibel me programin egzistues. Operatori Ekonomik duhet te ofroje te gjitha licensat e nevojshme per te shtuar radiot ne programin e dispatcherit. Programi egzistues i dispatcherit eshte Smart Dispatch

Plus i prodhuesit Hytera. Gjithashtu OE duhet te siguroj licensat per komunikimin e radiove ne rrjetin LTE.

9.4 Duplexer VHF

- Duplexeri duhet te suportoj kalibrimin ne frekuencat 152-175 MHz.
- Duplexer me te pakten 6 cavity.
- Te suportoj fuqi deri ne 50W ne hyrje.
- Impedance - 50Ω
- Humbja jo me shume se 1.2dB.
- Temperaturua e punes nga -30°C deri ne +60°C

9.5 Antene VHF

- Te punoje ne frekuencat : 154 – 170 MHz.
- Impedanca - 50Ω.
- Polarizimi – vertikal.
- Gain te pakten 4 (dBd).
- Temperaturua e punes nga -35°C deri ne +80°C.
- Te duroje ere me shpejtesi deri ne 160 km/h.

9.6 Software konfigurimi dhe monitori i perseritesve (Repeater)

Operatori Ekonomik duhet te ofroje nje software te plote per monitorim dhe konfigurim e perseritesve funksioni kryesor i te cilit do te jete monitorimi nga distanca i funksionimit te perseritesve per te pare nese ka probleme dhe cfare problemesh jane. Ky software duhet te jete kompatibel me perserites egsitues te cilet jane Hytera HR1065. Gjithashtu ky software do te lejoje konfigurimi e perseritesve ne distance. Disa nga funksionet qe ky software duhet te kete jane si me poshte:

- Monitorim ne kohe reale i perseritesve duke treguar parametrat dhe duke krijuar alarme audio nese parametrat nuk jane ne gjendje optimale.
- Ky program duhet te tregoj ne harte te gjitha radiot qe ndodhen ne diapazonin e perseritesit ne menyre qe edhe te optimizohet me mire sistemi duke ditur mbulimin e perseritesit.
- Te mund te kryej konfigurim ne remote te perseritesve Over the Air.
- Te kete mundesi qe alarmet ti dergoj me email.
- Te kete mundesi te marr te gjitha te dhenat e perseriteve dhe exportimi i tyre per analizime te mevonshme.
- Te kete mundesi te krijoje perdorues me te drejta te ndryshme.

9.7 Radio link microwave

Radio do te perdoret per komunikime Pike me Pike (Point-to-Point) ne frekuencat e licensuara. Kjo radio duhet te kete specifikimet e meposhtme:

- Te punojne ne bandat 6, 7, 8, 11, 13, 15, 18 dhe 23 GHz.
- Te ofroje nga 1+0 deri ne 4+0 single ose dual polarization.
- Radio duhet te suportoj 1+1/2+2 HSB, 1+1/2+2 HSB-SD dhe 2+0 XPIC.
- Duhet te suportoj MC-ABC (Multi-Carrier Adaptive Bandwidth Control).
- Radio duhet te perdor ne menyre eficente spektrin duke perdorur modulimin 4096-QAM me ACM (Adaptive Coding and Modulation).
- Te suportoj brez nga 14 MHz deri ne 224 MHz.

- Te suportoje XPIC (Cross-Polarization Interference Cancellation) per te ofruar throughput te larte duke perdorur 2 streame te pavaruara.
- Te suportoje teknologjine 2x2 dhe 4x4 LoS MIMO.
- Te suportoje teknologjine AFR (Advanced Frequency Reuse).
- Te suportoje teknologjine ASD (Advanced Space Diversity).
- Radio duhet te kete nderfaqet e meposhtme:
 - Port per ushqim DC
 - Porte PoE RJ 45 qe ofrojne shpejtesi deri ne 10 Gbps.
 - Porte dual band SFP qe ofron shpejtes 1 ose 2.5G.
 - 2 porta SFP+ qe ofrojne deri ne 10 GE.
 - Porte RJ45 per menaxhim.
- Radio te suportoje MTU (Maximum Transmission Unit) ku paketa me e madhe data e shkembyer ne nje transmetim te vetem te jete deri ne 9612 bytes.
- Disa nga protokollet QoS (Quality of Service) qe radio duhet te suportoje jane:
 - Disa kriteret klasifikimi si VLAN ID, p-bits, IPv4 DSCP, IPv6 TC, MPLS EXP.
 - 8 rradhe (queues) CoS per port
 - WRED (Weighted Random Early Detection)
- Te suportoje VLAN.
- Te suportoje protokollet e meposhtme te rrjetit:
 - MSTP (Multiple Spanning Tree Protocol) per te parandaluar krijim e loopeve ne rrjet dhe njekosisht te ofroje shpejtesi dhe balancim te ngarkeses.
 - ERP (Ethernet Ring Protection) (ITU-T G.8032) per te ofruar besueshmeri dhe mbrojtje ndaj loopeve per topologjine Ring.
 - Y.1731 Ethernet OAM per te ofruar mjete per monitorimin e performances dhe menaxhimin e defekteve ne rrjetin Ethernet ne nivelin carrier-grade, duke shtuar opsione si humbja e frameve, vonesen, jitter, matjen e throughputit etj.
- Te suportoje protokollet e meposhtme te menaxhimit:
 - SNMP (Simple Network Management Protocol)
 - REST API (Representational State Transfer Application Programming Interface)
 - NETCONF(Network Configuration Protocol) / YANG (Yet Another Next Generation).
- Te suportoje standartet e meposhtme per sinkronizim:
 - ITU-T G.8262.1 per te garantuar stabilizimin e frekuences dhe sinkronizimin e shtreses fizike.
 - ITU-T G.8273.2 per te garantuar saktesine e clock, gabimin maksimal si dhe klasen e performances.
 - ITU-T G.8273.3 per te ndihmuar ne precizion me te larte si dhe me pak gabime cumulative.
 - ITU-T G.8271.1 per te percaktuar limitet maksimale te gabimit te kohes ne rrjet dhe sa gabim lejohet nga nje paisje.
 - ITU-T G.8275.1 per te rregulluar dergimin e paketave PTP.
 - IEEE1588-2008 per sinkronizim shume te sakte kohe si dhe per te sherbyer si master clock dhe shperndarjen e kohes tek paisjet e tjera.
- Te suportoje protokollet e meposhtme te sigurise:
 - HTTPS (Hypertext Transfer Protocol Secure)
 - SNMPv3 (Simple Network Management Protocol Version 3)
 - SSH (Secure Shell)
 - Radius (Remote Authentication Dial-In User Service)
 - TACACS+ (Terminal Access Controller Access-Control System Plus)
 - Enkriptim AES (Advanced Encryption Standard) 256-bit.
- Te suportoje protokollet e meposhtme:
 - Carrier Ethernet 2.0

- 10/100/1000 base-T/X (IEEE 802.3)
- Optical 10G Base-LR (IEEE 802.3)
- Ethernet VLANs (IEEE 802.3ac)
- Virtual LAN (IEEE 802.1Q)
- CoS (Class of Service) (IEE 802.1p)
- Link aggregation (IEEE 802.1ax)
- Provider bridges (QinQ - IEEE802.1ad)
- Auto MDI/MDIX per Base-T
- IPv4 TOS (Type of Service)
- IPv4 DSCP (Differentiated Services Code Point)
- IPv6 Traffic Class
- Radio duhet te jete ne perputhje me EN 302 217-2-2 ne lidhje me eficence spektrale.
- Radio gjithashtu duhet te jete ne perputhje me:
- EMC: EN 301 489-1, EN 301 489-4, Class B (Europe) per te garantuar qe radiot nuk krijojnë interferencë elektromagnetike të tepërt dhe vazhdojnë të funksionojnë normalisht kur ekspozohen ndaj interferencave.
- EN 61000-4-29 per te garantuar rezistencen e paisjve DC ndaj renies se tensionit, nderprerjen e shkurter te energjise apo luhatjeve te tensionit.
- EN61000-4-5, Class 4 per te garantuar rezistence ndaj shkarkesave atmosferike (jo direkte) dhe paisja te vazhdoje punen normalisht.
- EN 60950-1, EN 60950-22 per te garantuar mbrojtjen e perdoruesit nga goditja elektrike, mbrojtje nga zjarri, izolim i duhur elektrik, tokezim i sigurte.
- Radio te kete mbrojtje IP67
- Te punoj ne temperatura nga -33°C deri ne +55°C

Radio duhet te jete e paisur me nderfaqe OMT (Orthomode Transducer) per tu lidhur direk me antenen.

Radio duhet te jete e paisur me aksesoret e pershtatshem per tu montuar ne kulle me lartësi jo më pak se 15 m.

Radio gjithashtu duhet te jete e paisur me licensat e meposhtme:

Kapaciteti i licensuar te jete te pakten deri ne 500 Mbps.

Te kete license per ACM (Adaptive Coding & Modulation).

Te kete garanci te pakten 2 vjet nga prodhuesi ku te mbuloje cdo lloj demtimi.

9.8 Shkarkues mbitensioni

- Shpejtesia e transmetimit jo me pak se 2.5G Base-
- Lidhja: Porte RJ-45
- Tensinoi nominal: 56V
- Modaliteti mbrojtjes: Linje- linje dhe linje – toke
- Koha e reagimit: ≤ 5 nanosekonda
- Siguresa jo me pak se 172A ne 10/1000 μ s.
- Te punoj ne temperatura nga - 40°C deri ne +60°C
- Lageshtia: 100% kondesim
- Te mund te rezistoje eres me shpejtesi deri ne 320 kph.
- I pershtatshem per montim ne shtylle ose ne mur.
- Te jete ne perputhje me: IEC 62368 edition 2 per te garantuar mbrojtjen e perdoruesit nga goditja elektrike, mbrojtje nga zjarri, izolim i duhur elektrik, tokezim i sigurte

9.9 Antene microwave 0.9m

- Antena te kete diameter 0.9 m (3 ft).
- Te punoj ne banden 5.925 – 7.125 GHz
- Polariteti: single
- Te shoqerohet me aksesor per montimi ne kulle me lartësi jo më pak se 15 m.

9.10 Antene microwave 1.2m

- Antena te kete diameter 1.2 m (4 ft).
- Te punoj ne banden 5.925 – 7.125 GHz
- Polariteti: single
- Te shoqerohet me aksesor per montimi ne kulle me lartësi jo më pak se 15 m.

9.11 Software monitorimi dhe konfigurimi per rrjetin Radio link

Ky software do sherbej per monitorimin ne kohe reale si dhe konfigurimi, upgrade firmware etj jo vetem per radio PTP por dhe infrastrukturen dhe switchet. Ky software duhet te instalohet ne nje server ose workstation ne DPB. Funksionet qe do te ofroje jane si me poshte:

- Ky software eshte per te menaxhuar te gjithë sistemin.
- Menaxhim i sigurte me enkriptim end-to-end.
- Operacione të thjeshtuara dhe mirëmbajtje të vazhdueshme për administratorin e rrjetit.
- Software te jete i zgjerueshem dhe te kete mundesi te menaxhoje me teper se 10000 paisje.
- Te kete mundesi te regjistroje deri ne 200 perdorues me te drejta te konfigurueshme.
- Te kete mundesi te mbaj te dhenat per nje kohe te gjate (deri ne 2 vjet)
- Te kete mundesi te instalohet lokalisht dhe te jete pjese e rrjetit te brendeshem.
- Te suportoje Zero Touch onboarding per paisjet e reja qe shtohen ne software.
- Paisjet te konfigurohen me ane te templeteve.
- Te suportoje RESTful API
- Te suportoje AutoProvisioning.
- Pamje e plote e te gjithë rrjetit.
- Te suportoje te gjitha paisjet qe nga Radiot dhe deri te switch duke bere monitorimin e komplet rrjetit vetem nga nje software.
- Shfaq pamen e paisjeve ne menyre hierakike.
- Backup i sistemit me skedule.
- Upgrade i firmware te paisjeve ne menyre automatike ose manuale.
- Dashbord i dedikuar per paisje.
- Dashbord per statistika dhe trendi i sistemit.
- Alertet me email.
- Suporton disa detyra paralele per paisje.
- Te suportoje bllokimin e konfigurimit (configuration lock).
- Komunikim me paisjet te jete ne SSL.
- Nuk ka nevojë per akses ne internet.
- Mundesi per disaster recovery.
- Export te raporteve dhe statistikave ne CSV.
- Exportim i tabelave UI ne CSV.
- Raporte grafike
- Akses ne program duke u bazuar ne role.
- Te suportoje log in nepermjet Radius, TACACS+, LDAP dhe Active Directory.
- Te mundesoj menaxhim sesionesh.
- Te mund te kete server backup per High availability.
- Load Balancing.

9.12 Switch i menaxhueshem 8 porta PoE, 4 SFP

Switchi duhet te jete ne perputhje me specifikimet e meposhtme:

- Throughput – jo me pak se 96 Gbps
- Forwarding rate – jo me pak se 120 Mpps (per paketa 64 Byte)
- Te kete te pakten 8 porta RJ45 me shpejtesi 10/100/1000.
- Te kete te pakten 4 porta SFP+ me shpejtesi deri ne 10 Gbps.
- Portat RJ45 te jene PoE+ conform 802.3 af/at/bt.
- Te pakten 2 prej portave te supportojne fuqi te larte (High PoE) deri ne 90W.
- Te pakten 4 prej portave te supportojne Low Voltage Passive PoE per tension 24V.
- Te kete nje porte seriale per console.
- Te jete i paisur me aksesori per montim ne rack.
- Te kete buton reseti.
- Te kete mundesi te punoje ne temperatura -30°C deri ne +60°C
- Tabela e adresave MAC jo me e vogel se 16K.
- Memorie Flash jo me te vogel se 128 MB.
- Memorie DRAM jo me te vogel se 512 MB.
- Te mund te menaxhoje deri ne 4000 vlane.
- Te suportojne LACP (Link Aggregation Control Protocol) me te pakten 8 linqe per LAG (Link Aggregation Group).
- Te QoS priority queues dhe jo me pak se 8.
- Te suportojne PVRST (Per-VLAN Rapid Spanning Tree) dhe jo me pak se 32 vlane.
- Te suportojne ACL ne hyrje dhe ne dalje dhe jo me pak se 128 lista.
- Te suportojne deri ne 512 hyrje ARP.
- Te suportojne deri ne 64 Static Routes.
- Te suportojne deri ne 512 Dynamic Routing.
- Te suportojne deri ne 256 IGMP Multicast Groups.
- Te kete mundesi te konfigurohet duke perdorur Policy Based Automation.
- Te kete mundesi per menaxhim trafiku duke u bazuar ne ACL.
- Te suportojne protokollet dhe standartet e meposhtme:
 - Autentikim duke perdorur standartin IEEE 802.1x per te karantuar autentifikim te sigurte.
 - DHCP snooping
 - Autentikim duke perdorur protokollet Radius / Tacacs+
 - SSH v2 (Secure Shell Version 2)
 - SNMP V1/V2/V3 (Simple Network Management Protocol)
 - Inter-VLAN Routing
 - Static ARP (Address Resolution Protocol)
 - Static Routes
 - DHCP Relay
 - RIP (Routing Information Protocol) V1 dhe V2 per rutime dinamike
 - OSPF (Open Shortest Path First) v2 per rutime dinamike
 - Route Redistribution
 - IEEE 802.1s Multiple spanning tree
 - IEEE 802.1q VLAN
 - Auto MDI/MDIX
 - BPDU (Bridge Protocol Data Units) Guard
 - IGMP (Internet Group Management Protocol) Snooping V1/V2/V3
 - IEEE 802.1 ab LLDP Link Layer Discovery Protocol
 - IGMP (Internet Group Management Protocol) Proxy

- Static MAC
- Floë Control per porte
- Port Mirroring: duke u bazuar ne port, ne ACL (Access Control List) ose ne VLAN
- Port Isolation
- Rate Limiting / storm control
- Jumbo frame
- DoS protection
- ICMPv6 (Internet Control Message Protocol version 6)
- Simple Netëork Time Protocol (SNTP)
- TFTP (Trivial File Transfer Protocol) / SFTP (Secure File Transfer Protocol)
- Menaxhim ne ëeb duke perdorur HTTPS (Hypertext Transfer Protocol Secure).

9.13 Monitor 24"

- Rezulucioni \geq Full HD 1920 x 1080
- Dynamic contrast ratio \geq 20 000 000:1 (DCR)
- Kendi i shikimit \geq 178°/178°
- Madhesia e ekranit te pakten 24"
- Koha e pergjigjes jo me e madhe se 5 ms
- Ndricimi jo me pak se 250 cd/m²

Portat Video hyrese

- Diplay port \geq 1
- HDMI \geq 1
- VGA \geq 1 15 Pin

Audio

- Hyrje jack 3.5mm \geq 1
- Boks audio te inegrUAR

Specifikimet elektrike

- 100-240 VAC
- Frekuenca 50/60 Hz
- Fuqia maksimale \leq 18W

9.14 Ëorkstation

- Forma: Toëer
- Te jete i paisur me procesor me jo me pak se 30000 pike sipas vleresimit te cpubenchmark i cili verifikohet ne linkun (www.cpubenchmark.net)
- Te jete i paisur me te pakten 32GB Memorie DDR5
- Te kte te pakten 1TB storage SSD NVME
- Te jete i paisur me karte grafike me dalje te pershtatshme per monitoret e mesiperm.
- Te jete i paisur me DVD+/-RW
- Te jete i paisur me mouse dhe tastiere.
- Sistemi i operimit te jete i licensuar

9.15 UPS 1000 VA

- UPS online me konvertim dopio sinusoidale
- Tensioni nominal i daljes : 220 VAC \pm 2%
- Kapaciteti min. : 1000VA.
- Tensioni i hyrjes : te suportoje nga 120 VAC deri ne 300 VAC.

- Frekuenca e hyrjes : 50 – 60 Hz.
- Faktori i fuqise : ≥ 0.97
- Forma e UPS : Rack mount
- Të ketë menu dhe display LCD per monitorim
- Të ketë mundësi për shtesë baterie për rritjen e kohëzgjatjes së autonomisë
- Të ketë ndërfaqe USB/Seriale për tu lidhur me kompiuterin dhe software e monitorimit

9.16 Stacion Energjie DC

- Stacion energjie automatik. Ne mungese te hyrjes AC baterite funizojne ngarkesen pa nderprerje. Ne momentin qe ka hyrje AC ushqyes funizon ngarkesen dhe gjithashtu karikon baterite.
- Te jete eficient dhe te mund te punoje ne kushte kritike.
- Karikimi i baterive te menaxhohet nga kontrolore me mikroprocesor.
- Te monitoroje statusin e baterive.
- Kabinet i forte prej inoksi i cili mund te mbaje nje ngarkese deri ne 250Kg.
- Te jete i paisur me bateri profesionale long life.
- Te jete i paisur me ekran lcd
- Te mund te paiset me karte SNMP per monitorim ne remote.
- Te jete i paisur me automat.
- Tensioni ne hyrje: 230 VAC $\pm 10\%$ 50-60 Hz
- Tensioni ne dalje: 56 VDC
- Rryma ne dalje jo me pak se 10A
- Autonomia jo me pak se 5 ore.
- Te mund te mbaje nje ngarkese deri ne 10A.
- Te jete i paisur me ventilator te kontrollueshem.
- Te punoj ne temperatura nga - 15°C deri ne +50°C
- Te kete sinjalizime ne paneli frontal nepermjet LED
- Te jete i paisur me multimeter dhe vlerat te shfaqet ne ekranin LCD.

9.17 Rack

- Rack 12U me mundesi per tu montuar ne mur.
- Dera ballore te jet me xham te temperuar sipas EN 12150-1, per te garantuar rezistencen mekanike, termike si dhe sjelljen kur thyhet.
- Struktura : material celiku
- Modular dhe i cmontueshem
- Dyert anesore te jene te cmontueshme.
- Cilesia e larte materiali metalik
- Te jete i paisur me shperndares tensioni PDU
- Te jete i paisur me panel per fiksimin e kablllove
- Te jete i paisur me ventilator.
- Te kete mundesi te mbaje deri ne 80Kg peshe.

9.18 Kabell FTP Cat6

- Frekuenca : ≥ 500 MHz.
- Diametri : 7.8 ± 0.2 mm.
- Te jete me dopio veshje.
- Ne perputhje me standartin ANSI/TIA-568-C.2 per te garantuar performance e kabllit.

- Ne përputhje me Standartin EN 50575 për të garantuar sigurinë dhe reagimin e kabllit ndaj zjarrit.

9.19 Kabell coaxial 7/8

- Madhësia : 7/8
- Për instalime të jashtme
- Impedanca – $50 \pm 1 \Omega$
- Frekuenca: 5Ghz

Afati i lëvrim: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT